

**VENDIM**  
**Nr. 70, datë 14.2.2024**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 887, DATË  
27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E  
MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 e 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, të pikës 1, pas togfjalëshit “... qartësisht të identifikuar...” shtohen fjalët “... pavarësisht burimit të financimit.”.

2. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Përrjashtëm nga ky rregull bëjnë projektet e investimeve publike që lidhen me rikonstruksionin e ndërtesave publike, blerjen e pajisjeve elektronike apo të pajisjeve të zyrave.”.

3. Në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) “Shpenzime kapitale administrative” përkufizohen si zëvendësimi i pajisjeve të vjetruara gjatë ushtrimit të funksioneve nga njësia e qeverisjes qendrore apo blerje të pajisjeve të reja që lidhen me nivelin aktual të personelit ose rritjen e numrit të stafit. Njësitë e qeverisjes qendrore përgatitin propozimet dhe i paraqesin në ministrinë përgjegjëse për financat të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me procedurat për vlerësim sipas aneksit 1, në përputhje me përcaktimin e nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Projektet e vlerësuara sipas këtij klasifikimi do të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Ministria përgjegjëse për financat shqyrton propozimet, duke i përfshirë, sipas rastit, në procesin e PBA-së apo buxhetin vjetor.”.

b) Kudo në përmbajtje të shkronjës “b” hiqet togfjalëshi “... PBA apo ...”.

4. Në fund të paragrafit të parë, të pikës 7, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Gjatë procesit të programimit të projekteve të investimeve publike prioritet për financim kanë projektet ekzistuese.”.

5. Në pikën 8 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në paragrafin e parë, pas fjalëve “Propozimet për projektet e reja të investimeve ...” shtohen “... pavarësisht burimit të financimit ...”.

b) Shkronjat “c” dhe “ç” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“c) Për projektet e investimeve publike, të cilat përfshihen në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, përpara maturimit, institucioni propozues paraqet studimin e fisibilitetit, duke siguruar cilësinë e tij në përputhje me përcaktimet e shtojcës 4, bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilat:

i. ministria përgjegjëse për financat vlerëson përballueshmërinë buxhetore të projektit dhe risqet fiskale lidhur me deficitin buxhetor dhe borxhin publik;

ii. institucioni përgjegjës për programimin strategjik jep mendim për plotësimin e dokumentacionit sipas kritereve të këtij vendimi dhe rivlerësimin e përputhshmërinë me strategjitë kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale;

iii. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) jep mendim në tërësi për përmbushjen e elementeve të studimit të fizibilitetit të projektit, vetëm për projektet që paraqiten sipas modulit PPP.”

“ç) Projekti konsiderohet i maturuar me miratimin e Komitetit të Planifikimit Strategjik.”

c) Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1”, me këtë përmbajtje:

“ç/1) Institucioni përgjegjës për programimin strategjik reflekton ndryshimin e statusit të maturitetit të projekteve që maturohen dhe rivlerëson rankimin e projekteve në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.”

6. Në pikën 9 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjalja e parë hiqet.

b) Pas togfjalëshit “... rankimin e projekteve ...” shtohet “... të maturuara ...”.

7. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të njësisë së qeverisjes qendrore të shpërndahen më pak se 20% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të parë. Gjatë zbatimit të projekteve të investimeve publike nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të njësisë së qeverisjes qendrore të shpërndahen më pak se 30% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të dytë dhe jo më pak se 30% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të tretë, përveç rasteve ku përcaktohet ndryshe në dokumentin e studimit të fisibilitetit dhe projektet e reja të miratuara në PBA 2023-2025. Për projektet e investimeve publike me financim të huaj ndiqen rregullat e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse me institucionin financiar.”

8. Pas pikës 13 shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:

“13/1. Projektet e investimeve me statusin “i maturuar” në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, të miratuara me vendimin nr. 447, datë 26.7.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2024–2026”, përfshihen në PBA apo buxhetin vjetor, pasi:

a) institucioni përgjegjës për programimin strategjik të kryejë rankimin e projekteve;

b) ministria përgjegjëse për financat të vlerësojë përbalueshmërinë buxhetore të projektit në përputhje me hapësirat fiskale.”

9. Në shtojcën 4 “Studimi i fisibilitetit”, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në paragrafin e dytë, pas togfjalëshit “Cilësia e konceptimit ...” shtohet “... dhe përmbajtjes ...”.

b) Pas paragrafit të tretë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Bazuar në natyrën e projektit, institucioni propozues, duke argumentuar, mund të vlerësojë si të paaplikueshme një apo disa seksione të udhëzimit të mëposhtëm:”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**